

F/V Shpenzime për Infrastrukturën Civile

LIDHJA 3 – KËRKESAT E VEÇANTA PËR KUALIFIKIM

➤ **KAPACITETI TEKNIK DHE PROFESIONAL**

1. LICENCA PROFESIONALE TE SHOQERISE PER ZBATIMIN E PUNIMEVE NE NDERTIM

Operatori duhet të paraqesë Liçensë Profesionale të shoqërisë për zbatimin e punimeve të ndërtimi, të vlefshme, sipas legjislacionit në fuqi, për pikat e mëposhtme:

1. *NP – 3 A Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale;*
2. *NS – 1 A Punime per prishjen e ndertimeve;*
3. *NS – 4 A Punime rifiniture dhe të lidhura me to, ...;*

Individët apo personat juridik të cilët disponojnë liçensa të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 42 date 16.01.2008. Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, duhet të bëjnë rinovimin dhe ekuivalentimin e tyre.

Operatorët e huaj, duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës), Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2. MAKINERITE DHE PAISJET

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qera; Dëshim për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Operatori/ët ekonomik, të vetëdeklarojnë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), për mjetet dhe paisjet si më poshtë:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamioncine	Në pronësi ose me qera	Copë	1
2	Kamion vetshkarkues me vinç, kapacitet mbajtes min 3 ton.	Në pronësi ose me qera	Copë	1
3	Elektro - Betoniere	Në pronësi ose me qera	Copë	1
4	Matrapik	Në pronësi ose me qera	Copë	1
5	Gjenerator	Në pronësi ose me qera	Copë	1

Ky dokumentacion, përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST-së.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

A. Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Police për sigurimin e detyrueshem ndaj palëve të treta (T.P.L), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.

B. Për mjetet me Qera që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Police për sigurimin e detyrueshem ndaj palëve të treta (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.
5. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

C. Për mjetet në Pronësi që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore e blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.

D. Për mjetet me qera që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore të blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara;
2. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.

E. Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar, si më poshtë vijon duhet të disponojë :

- Kokore mbrojtese, minimumi 10 copë;
- Jeleke Fosforeshente, minimumi 10 copë;
- Fikëse zjarri të lëvizshme, minimumi 2 copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën, minimumi 2 copë;
- Karroca dore, minimumi 2 (dy) cope;
- Komplete ndimës së shpejtë, minimumi 2 copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 2 copë.

Është e mjaftueshme paraqitja e vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 të DST-së.

Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të vetëdeklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese) sipas Shtocës Nr. 8 të DST-së. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Operatori/et ekonomik ofertues, duhet të deklarojë, që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera, afati i zbatimit të të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt prokurimi, janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve, si gjatë vlerësimit të ofertavë ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rast deklarimi të rremë, do të veprohet në përputhje të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Dokumentacioni provues, i cili vërteton se operatori ekonomik disponon mjetet sa me sipër, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet mbi makineritë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

3. STAFI DHE FUQIA PUNETORE

Operatori Ekonomik duhet të vetëdeklarojë (sipas Shtojcës 8 të DST) se disponon fuqinë minimale punëtore jo më të vogël se **15 (pesëmbëdhjete)** punonjës të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit për periudhën **Janar 2023 – Mars 2023**.

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që ky dokumentacion të paraqitet nga operatori ekonomik fitues para lidhjes së kontratës ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, pasi kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatori ekonomik të:

a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore/Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën Janar 2023 – Mars 2023.

b) Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar Janar 2023 – Mars 2023.

3.1 Staf

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si Drejtues Teknik në licence e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, libereze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Janar 2023 – Mars 2023) si më poshtë:

- ✓ 1 (nje) Inxhinier ndërtimi,

Operatori/ët Ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin/t Teknik të punimeve në kantier, në Portin e Durrësit për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i dypunësuar apo i angazhuar në kontrata të tjera.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Drejtuesit Teknik nuk duhet të jenë të dypunësuar. Kjo në zbatim të V.K.M. Nr. 42, datë 16.01.2008, Kreu IV, pika 2. Si rrjedhojë O.E. duhet të deklarojë se Drejtuesit Teknik nuk janë të dypunësuar apo të angazhuar në ndonjë veprimtari tjetër jashtë O.E. pjesëmarrës. A.K. rezervon të drejtën e verifikimit të Deklaratës.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

3.2 Fuqia Punetore

3.2.1 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2023 – Mars 2023 si më poshtë:

- Punonjës suvaxhi 3 (tre)
- Punonjës Hidroizolues 2 (dy)
- Punonjës Bojaxhi 2 (dy)
- Punonjës Elektracistë 2 (dy)
- Punonjës Pllakashtrues 2 (dy)
- Punonjës Punime gips 2 (dy)
- Punonjës Punime duralumini/pvc 1 (një)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës.
- Diplomë/certifikate e arsimit profesional, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional(publik/privat) të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa.

- Certificate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuara nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve te pu	Nr. Amzes/ ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	-------------------------------------	--	------------------------------------	--

4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikata:

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit.

Për këtë duhet të paraqesë çertifikatat e mëposhtme:

- **Çertifikatë EN-ISO 9001-2015** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë, e vlefshme*). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në

varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

- **Çertifikatë EN-ISO 14001-2015** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit, e vlefshme*). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).
- **Çertifikatë EN-ISO 45001-2018** ose ekuivalenti i tij (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e vlefshme*). Në rastë bashkimi të OE, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës së zërave të punës të marrë sipas Akt – Marrëveshjes së Bashkëpunimit).

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkomëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit, duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Akt – Marrëveshjes).

Nëse ofertuesi do të paraqitet si Bashkim Operatorësh, certifikatat duhet të jenë në përputhje me punimet e marra sa më sipër.

5. OPERATORI/ËT EKONOMIK OFERTUES DUHET TË PARAQESIN:

5.1 Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST-së), të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

5.2 Planin e organizimit të punimeve.

5.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori për: materialet elektrike, boje hidroplastike, materiale hidroizoluese, pllakë shtrimi grez porcelanato, dhe parket laminat. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit.

5.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesi katalog /skede teknike për materialet elektrike, boje hidroplastike, materiale hidroizoluese, pllakë shtrimi grez porcelanato, dhe parket laminat.

5.5 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me standartet e kerkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion justifikues (certifikata/deklarata prodhuesi/test raporte) për standartet dhe kërkesat që duhet të përmbushin zërat e kerkuara në formularin e specifikimeve teknike.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet mbi makineritë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i perfundimit të punimeve është 30 ditë pune.

*KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
PERLLOGARITJES SE VLERES SE KONTRATES*